



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. F-5/4 Prot.

Tiranë, më 08.02/2021

URDHËR

Nr. 63, Datë 08.02.2021

**“PËR
HEQJEN E LICENCËS SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT, FARIJE
DERRI”**

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, të nenit 6, të nenit 7 pikës 2 të Ligjit Nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, gërmës “dh”, të pikës 1, të nenit 21, të Ligjit Nr. 110/2018 “Për noterinë”,

KONSTATOJ:

Referuar urdhrit nr. 214, datë 21.03.2019, “Për përcaktimin e listës së dokumenteve për rifreskimin e dosjes së plotë personale të noterëve dhe asistent noterëve”, pranë Ministrisë së Drejtësisë, është paraqitur dosja personale me dokumentacionin e rifreskuar si noter e znj. Farije Derri, dërguar më datë 24.05.2019 dhe administruar me nr. F-103 prot., datë 27.05.2019.

Pas administrimit të dosjes dhe evidentimit të dokumentacionit të përcjellë dhe dokumentacionit të munguar, është proceduar më kërkesën me nr. F103/1 prot., datë 06.09.2019, për plotësimin e dosjes me dokumentacionin e munguar.

Bazuar në ligjin nr. 110/2018, datë 20.12.2018, “Për noterinë”, si dhe në përmbushje të gërmës “d”, pika 3 të urdhrit nr. 214, datë 21.03.2019, për “Përcaktimin e listës së dokumenteve për rifreskimin e dosjes së plotë personale të noterëve dhe asistent noterëve”, pikës 1 dhe 7, të urdhrit nr. 396, datë 31.07.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin dhe verifikimin e listës së plotë të dokumenteve për rifreskimin e dosjes së plotë personale të noterëve dhe asistent noterëve”, Ministria e Drejtësisë, ka kërkuar verifikimin e gjendjes gjyqësore të noterëve.

Me anë të shkresës me nr. V-2754/2 prot., datë 19.09.2019 Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve na ka vënë në dijeni se shtetasja, znj. Farije Derri, rezulton e dënuar. Vërtetimi i Gjendjes Gjyqësore me nr. 17 prot., datë 18.09.2019, mban shënimin “Në bazë të Vendimit nr. 98 datë 05.06.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës është vendosur deklarimi fajtor i të pandehurit për veprën penale të “Falsifikimit të dokumentave” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 186/3-25 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dhe nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënohet me 12 muaj

burgim. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim për një afat kohe prej 18 muajsh. Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. 229 dt. 26.05.2016 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm”.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se noteria në deklaratën mbi gjendjen gjyqësore nuk e ka deklaruar faktin që është e dënuar me vendim penal të formës së prerë për veprën penale të “Falsifikimit”, vepër penale e kryer gjatë ushtrimit të funksionit të noterit. Në vijim, pas evidentimit të dokumentacionit të përcjellë dhe dokumentacionit të munguar, është proceduar me shkresën me nr. F-103/3 prot., datë 24.05.2020 me objekt “Përcillet Raporti i Vlerësimit Paraprak”. Rezulton se, është kthyer përgjigje me shkresën protokolluar me nr. F-103/4 prot., datë 28.05.2020. Nga ana e noteres është shpjeguar fakti se ka qenë e pavendosur apo e qartë, nqs duhet të deklaronte ose jo nëse vazhdonte të ishte e dënuar apo nëse ishte e rehabilituar. Së pari, ishte një vendim me kusht, së dyti ka vuajtur apo e ka kryer këtë dënim në vitin 2015 dhe së treti, sipas noteres ka kaluar një periudhë kohore afto 5 vjet. Së katërti, fakti që e ka lënë të pavulosur formularin është në këtë logjikë dhe se nuk ka patur ndonjë qëllim fshehje apo mosdeklarimi.

Më tej, është proceduar me dërgimin e Raportit të vlerësimit përfundimtar të dosjes së noteres Farije Derri, përcjellë me shkresën nr. F-131 Prot., datë 04.12.2020, ku rekomandohet heqja e licencës së noterit në bazuar në pikën 14, gërma “i”, të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr.396 datë 31.07.2019 “Për Ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin dhe verifikimin e listës së plotë të dokumenteve për rifreskimin e dosjes së plotë personale të noterëve dhe asistent noterëve”, të ndryshuar, pasi jemi në kushtet e nenit 21, pika “dh” të ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”. Sipas shkresës së sipërcituar, noteres i është lënë afati 7 ditor për përcjelljen e kundërshtimeve ndaj Raportit të vlerësimit përfundimtar.

Noterja ka kthyer përgjigje me shkresën nr. F-131/1 prot., datë 18.12.2020, duke përcjellë kundërshtimet e raportit të dërguar. Në këtë shkresë përmes av. E. B, është parashtruar se rekomandimi është i gabuar dhe rrjedhimisht, kërkohet të mos merret në konsideratë. Gjithashtu, është parashtruar se për kërkesën për informacionin nëse noterja është e dënuar apo jo, ajo ka bërë me dije se nuk rezulton e dënuar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar. Bashkëlidhur kësaj shkrese, është përcjellë Vërtetimi i Gjendjes Gjyqësore nr. 17, datë 15.01.2020, sipas të cilit, noterja rezulton e padënuar.

Nga sa më sipër, rezulton se të dhënat mbi gjendjen gjyqësore të shtetases së sipërcituar në vërtetimet me nr. 17 prot., datë 18.09.2019 dhe me nr. 17 prot., datë 15.01.2020, nuk përputhen.

Për këtë arsye, struktura përgjegjëse i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me shkresën nr. F-13/2 prot., datë 30.12.2020, me qëllim verifikimin edhe një herë të gjendjes gjyqësore të znj. Farije Derri. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka kthyer përgjigje me shkresën nr. F-131/3 prot., datë 06.01.2021, ku nga verifikimi i Regjistrat Elektronik të Gjendjes Gjyqësore rezulton se znj. Farije Derri është deklaruar fajtores me vendimin nr. 98, datë 05.06.2014 dhe është dënuar me 12 muaj burgim. Në zbatim të nenit 59, të Kodit Penal pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim për një afat kohe prej 18 muajsh. Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. 229, datë 26.05.2016 ka vendosur “lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë”. Në zbatim të nenit 69/b të Kodit Penal znj. Farije Derri është rehabilituar më 05.06.2019.

Sa më sipër, duke marrë në konsideratë rëndësinë e informacionit të kërkuar, me qëllim evidentimin e informacionit të saktë u kërkuar informacion nga Shërbimi i Provës, për të dhënat e shtetasës Farije Mehmet Derri, e datëlindjes 24.05.1971.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës na ka vendosur në dijeni se, noterja znj.Farije Derri është deklaruar fajtores për kryerjen e veprës penale “Falsifikim i dokumentave” me vendimin nr. 98 datë 05.06.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Gjithashtu me vendimin nr. 299 datë 14.12.2017 noterja është deklaruar fajtores për kryerjen e veprës penale “Falsifikim i dokumentave” tre herë, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, dhe aktualisht është subjekt nën mbikqyrje.

Në vijim u kërkuar informacion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, si dhe nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës. Me shkresën nr. 11, datë 11.01.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës ka përcjellë për njohje:

- vendimin e gjykataës nr. 98 datë 05.06.2014, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër me Vendimin nr.229, datë 26.05.2016; si dhe,
- vendimin nr. 299 datë 14.12.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës , vendim i cili nuk ka marrë formë të prerë.

Nga shqyrtimi i akteve të përcjella rezulton se në vendimin e gjykatës nr. 98, datë 05.06.2014, ka dy shënime kontradiktore lidhur me hyrjen në fuqi të këtij vendimi. Së pari referohet *“Ky vendim hyn në fuqi me datë 16.06.2014 pasi vendimi nuk është ankimuar”* si dhe shënimi *“Ky vendim është ankuar në Gjykatën e Apelit Shkodër e cila me Vendimin nr.229, datë 26.05.2016 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 98 datë 05.06.2014”*.

Pasi është njohur me vendimin nr. 98 datë 05.06.2014, i cili është ankuar në Gjykatën e Apelit Shkodër e cila me Vendimin nr.229, datë 26.05.2016 ka vendosur lënien në fuqi, prokurori Edmond Kariqi ka nxjerrë Urdhrin nr. 133 datë 08.07.2016 “Për ekzekutimin e Vendimit Penal”. Ky vendim i është përcjellë Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës Kukës me shkresën nr. 1289 datë 27.07.2016.

Gjithashtu, nga informacioni i dërguar nga Drejtoria e Përgjishme e Shërbimit të Provës rezulton se Zyra Vendore Kukës me shkresën nr. 155/4 prot., datë 01.09.2016 i është drejtuar Prokurorisë së Rrethi Gjyqësor Kukës. Në këtë shkresë Zyra Vendore e Shërbimit të Provës Kukës shprehet se në zbatim të Urdhrit të Ekzekutimit nr. 133 datë 08.07.2016 ka thirrur znj. Farije Derri, që është paraqitur dhe ka deklaruar se vendimin nr. 98 datë 05.06.2014 e ka ekzekutuar nga data 21.07.2014 deri më datë 16.12.2015, edhe pse këte vendim e ka apeluar në Gjykatën e Apelit Shkodër.

ZVSHP Kukës shprehet se në dosjet e arkivuara rezulton se: Vendimi nr. 98 datë 05.06.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, ka marrë formë të prerë më datë 16.06.2014. Urdhri i ekzekutimit datë 27.06.2014, është ekzekutuar sipas vendimit të dhënë nga gjykata. Në këtë shkresë thuhet se ZVSHP Kukës ka dërguar Raport përfundimtar për të dënuarën Farije Derri me shkresën nr. 458 prot., datë 16.12.2015 dhe nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës është dërguar vendimi për kryerjen e dënimit alternativ datë 24.12.2016. ZVSHP Kukës ka vënë në dijeni prokurorinë se, e ndodhur përballë kësaj situate do të mbyllë dosjen, pasi nuk mund të ekzekutojë Urdhrin nr. 133 datë 08.07.2019 për Vendimin nr.98, datë 05.06.2014, për arsye se ky vendim është kryer nga ana e të dënuarës Farije Derri.

Drejtoria e Përgjishme e Shërbimit të Provës na ka vënë në dispozicion edhe vendimin për kryerjen e dënimit alternativ të prokurorit Edmond Kariqi. Në këtë vendim prokurori ka konstatuar se bazuar në raportin përfundimtar të ZVSHP Kukës, ardhur me shkresën nr. 155/4 datë 01.09.2016, rezulton se e dënuara Farije Derri ka përfunduar detyrimin për dënimin alternativ “Pezullim i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë”. Më tej me Vendimin për kryerjen e dënimit alternativ të datës 24.12.2015 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukë, është vendosur të konsiderohet i kryer dënimi alternativ për të dënuarën Farije Derri dhënë me vendimin nr. 98, datë 05.06.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës.

Me vendimin e datës 08.09.2016 ZVSHP Kukës ka vendosur mbylljen e dosjes personale të së dënuarës Farije Derri për shkak të kryerjes së dënimit alternativ sipas vendimit të prokurorit datë 24.12.2015

Me shkresën nr. F-5 Prot., datë 18.01.2021 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës na ka vendosur në dijeni se, bazuar në raportin përfundimtar të ZVSHP Kukës, ardhur me shkresën nr.458, datë 16.12.2015, rezulton se e dënuara Farije Derri ka përfunduar detyrimin për dënimin alternativ “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë”, sipas nenit 59 të Kodit Penal, dhënë me Vendimin nr.98, datë 05.06.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, duke zbatuar të gjitha detyrimet e vëna në vendimin e sipërcituar.

Për sa më sipër, arrihet në përfundimin se noter Farije Derri, në formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore ka fshehur të vërtetën duke deklaruar se nuk është e dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar apo i huaj.

Gjithashtu noterja Farije Derri rezulton e dënuar me vendimin nr. 299, datë 14.12.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, ku është vendosur:

- “- Deklarimin fajtores e të pandehurës Farije Derri, për kryerjen e veprës penale të “Fallsifikimit të dokumentave”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite e dënon me 1 vit burgim.*
- Deklarimin fajtores e të pandehurës Farije Derri, për kryerjen e veprës penale të “Fallsifikimit të dokumentave”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite e dënon me 1 vit burgim.*
- Deklarimi fajtores e të pandehurës Farije Derri, për kryerjen e veprës penale të “Fallsifikimit të dokumentave”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite e dënon me 1 vit burgim.*
- Në bazë të nenit 55 të Kodit Penal “Caktimi i dënimeve për disa vepra penale”, përfundimisht e panderura Farije Derri dënohet me 2 (dy) vjet burgim.*
- Në bazë të nenit 59 të Kodit penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, për të pandehurën Farije Derri, duke e vënë në provë për 4 (katër) vjet, me kusht që e pandehura të gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të mbajë kontakt me Shërbimin e Provës.*
- Në bazë të nenit 30 e 60/5 të Kodit Penal, të pandehurës i hiqet e drejta për të ushtruar veprimtarinë profesionale për një afat kohor 3 (tre) vjet”.*

Nga shqyrtimi i vendimit gjyqësor, konstatohet se noterja është dënuar për falsifikimin e akteve të hartuara në zyrën e saj gjatë vitit 2015. Fakt që tregon rrezikshmërinë e lartë shoqërore të noteres e cila në ushtrimin e funksionit të noterit gjatë kohës që ka qenë subjekt nën mbikqyrje për shkak të dënimit me Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës nr. 98, datë 05.06.2014, për të njëjtën vepër penale “falsifikim i dokumenteve”, ka kryer veprën penale të falsifikimit të dokumenteve tre herë, për të cilën është subjekt nën mbikqyrje pranë shërbimit të provës.

Sa më sipër, duke vlerësuar se detyra e noterit me karakter publik ka një rëndësi të veçantë, kryerja e veprës penale të falsifikimit vërtetuar kjo me vendimin nr. 98, i cili është i formës së prerë, si dhe fakti i marrjes së cilësisë së të pandehurës përsëri për të njëjtën vepër penale sipas vendimit nr. 299, datë 14.12.2017, bazuar në nenin 21, pika 1, gërma “dh” dhe gërma “i”, të Ligjit Nr. 110/2018 “Për noterinë”, në të cilin përcaktohet se *“Heqja e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit bëhet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, kur noteri:....dh) është dënuar pas marrjes së licencës me vendim gjyqësor të formës së prerë: i) për një vepër penale të kryer me dashje”*,

URDHËROJ:

1. Heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noteres Farije Derri, anëtare e Degës Vendore të Noterisë Shkodër.
2. Ngritjen e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:
 - a) Znj.Ina Papa, Sektori i Rregullimit të Profesioneve të Lira pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - b) Një noter i caktuar nga Dega Vendore e Noterisë;
 - c) Një noter i caktuar nga Dhoma Kombëtare e Noterisë
3. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noteres Farije Derri, nga Komisioni i caktuar në pikën 2, të këtij urdhri.
4. Të njoftohen menjëherë me përmbajtjen e këtij Urdhri institucionet e linjës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, Gjykatat e Shkallës së Parë dhe Apelit, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme.
5. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, Komisioni i Dorëzimit të Arkivit të verifikojë përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe akteve noteriale që përmban arkiva me veprimet e reflektuara në regjistrat noteriale, si dhe të evidentojë çdo mungesë dhe çdo dëmtim të dokumenteve arkivorë, nëse ka të tilla.
6. Arkivi noterial të merret në dorëzim me procesverbal në bashkëpunim me Degën Vendore të Noterisë Shkodër dhe Dhomën Kombëtare të Noterisë.
7. Dega Vendore e Noterisë Shkodër, brenda 7 ditëve nga marrja dijeni e këtij Urdhri, të përcjellë emrin e noterit për marrjen në dorëzim të arkivit, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të Ligjit Nr. 110/2018 “Për noterinë”.

8. Komisioni i Dorëzimit të Arkivit, pas administrimit të emrit të noterit, sipas pikës 7, të këtij Urdhri, merr masa për dorëzimin me procesverbal të arkivës noterit të përcaktuar nga Dega Vendore përkatëse e Noterisë, brenda 7 ditëve pune, pas kalimit të afatit të ankimit.

9. Ndaj këtij urdhri, noterja mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të tij

10. Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistrohen në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, pas kalimit të afatit të ankimit.

11. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij Urdhri. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
Etilda Gjonaj (Sahu)

